



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBITIMIT TË NDIHMËS
JURIDIKE PARËSORE

Nr. 284 Prot.

Tiranë, më 23.01 2026

Lënda: Kërkesë për publikimin e thirrjes për aplikim për autorizimin e organizatave jofitimprurëse në fushën e ndihmës juridike parësore.

BASHKISË TIRANË

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nr. 2, Tiranë

BASHKISË DURRËS

Adresa: Sheshi "LIRIA", Durrës

BASHKISË SHKODËR

Adresa: Rruga "13 Dhjetori", Shkodër

BASHKISË ELBASAN

Adresa: Sheshi "Aqif Pasha", Elbasan

BASHKISË VLORE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë

BASHKISË FIER

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Fier

BASHKISË KORÇË

Adresa: Bulevardi "Fan Noli", Korçë

BASHKISË BERAT

Adresa: Sheshi "Teodor Muzaka", Berat

BASHKISË GJIROKASTËR

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastër

BASHKISË LEZHË

Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti", Lezhë

BASHKISË LUSHNJË

Adresa: Sheshi "Kongresi i Lushnjës", Lushnjë

BASHKISË KAVAJË

Adresa: Sheshi "Demokracia", Kavajë

BASHKISË KAMËZ

Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", Kamëz

BASHKISË VORË

Adresa: Rruga "Dëshmorët e Vorës", Vorë

BASHKISË POGRADEÇ

Adresa: Rruga "Rilindasit", Pogradec

BASHKISË SARANDË

Adresa: Rruga "Abidin Dino", Sarandë

BASHKISË DELVINË

Adresa: Rruga "Rinia", Delvinë

BASHKISË TEPELENË

Adresa: Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë

BASHKISË KUKËS

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", Kukës

BASHKISË TROPOJË

Adresa: Rruga "Azem Hajdari", Bajram Curri

Të nderuar,

Ligji nr. 111/ 2017 "*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*" parashikon si një ndër format e ndihmës juridike edhe **ndihmën juridike parësore**.

"Ndihmë juridike parësore" është:

- a) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- b) dhënia e këshillimit;
- c) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- d) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- e) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe
- f) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Bazuar në nenin 13 të ligjit, ndihma juridike parësore ofrohet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;

- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë

Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë, procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe VKM-së Nr. 55, datë 06.09.2019 (e përditësuar) "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti", ka hapur thirrjen në kuadër të aplikimit për autorizim si dhe përfshirjen e organizatave të reja në skemën e ndihmës juridike parësore.

- Afati i aplikimit: *Brenda 30 ditëve nga data e publikimit të njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare në Qendrën e Botimeve Zyrtare (publikuar në dt. 19.01.2026).*
- Dokumentat që nevojiten janë të përcaktuara në thirrje: <https://qbz.gov.al/eli/njoftim/2026/01/14/177/6fb3b264-c5b6-4cdb-9749-7dfc72742e0a>

Në vijim të sa më sipër, në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional dhe rritjen e transparencës, ju lutemi që, nëpërmjet kanaleve tuaja zyrtare të komunikimit, veçanërisht në faqet zyrtare të internetit (ëcbsite), të bëni publikimin e thirrjes për aplikim të hapur nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Ky publikim synon informimin sa më të gjërë të organizatave jofitimprurëse që janë të interesuara për t'u autorizuar nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, si dhe për përfshirjen e tyre në skemën tonë.

Përhapja e këtij informacioni nëpërmjet platformave tuaja zyrtare do të kontribuonte në rritjen e aksesit në informacion, nxitjen e pjesëmarrjes së organizatave të reja dhe garantimin e një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe transparent, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË

(DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE)

Patricia Pogace

NJOFTIM
Nr. 177, datë 14.1.2026

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR AUTORIZIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", dhe të VKM-së nr. 55, datë 6.2.2019, "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti" (i përditësuar), bën publik njoftimin, si më poshtë:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse që janë të interesuara të aplikojnë për të marrë autorizim nga ministri i Drejtësisë për të ofruar ndihmën juridike parësore, duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

Shënim. Kjo thirrje është për organizatat e reja që dëshirojnë të bëhen pjesë e rrjetit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe jo për ato të autorizuar më parë nga ministri i Drejtësisë, në kushtet kur me ndryshimet e VKM-së nr. 55/2019, autorizimi jepet pa afat.

Procedura dhe dërgimi i dokumentacionit

Dokumentacioni që duhet të depozitojnë organizatat jofitimprurëse (OJF), për aplikim për marrjen e autorizimit që lëshohet nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:

Dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tre) vjet të veprimtarisë së tyre *(nuk është e domosdoshme të jenë projekte të 3 vjetëve të fundit, por kohëzgjatja e projekteve në total të mbulojë një periudhë kohore prej 3 vjetësh kalendarikë)*, duke përfshirë:

- Listën e rasteve të trajtuara ose projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tre) vjetëve, si dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore nga projektet e ndihmës juridike parësore;

- Raportet përfundimtare për secilin rast, ose raportet vjetore për projektet e listuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore, si dhe pasqyrat financiare për to;

- Në rast se organizata jofitimprurëse nuk ka zbatuar një projekt të posaçëm për ofrimin e ndihmës juridike parësore, por ky aktivitet është një komponent i një projekti tjetër, paraqiten dokumentet vetëm për këtë komponent, që lidhet me ofrimin e ndihmës juridike parësore;

- Pasqyrat financiare të 3 (tre) vjetëve të fundit të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm e të jashtëm, të përfshirë në këto projekte;

- Tabelë ku të evidentohen anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv;

- Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv *(i përditësuar i 3 muajve të fundit)*;

- Adresën elektronike të komunikimit të organizatës dhe numrin e kontaktit të përfaqësuesit.

Aplikimi për autorizim i shoqëruar me dokumentacionin e sipërpërmendur dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në adresën rruga "Jordan Misja", godina nr. 3, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë, **brenda 30 ditëve nga data e publikimit të njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare në Qendrën e Botimeve Zyrtare (QBZ)**

Dokumentet e sipërcituara duhet të jenë **origjinale** ose të njësuar me origjinalin. Aplikimet e paraqitura jashtë afatit dhe/ose jo në formatin e kërkuar nuk kualifikohen. Për çdo paqartësi mund të na kontaktoni në: dnjf@drejtesia.gov.al.